



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 588/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimit e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Akreditohet programi i studimeve të Kolegjit Universum kampusi kryesorë në Prishtinë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Psikologji, BSc, 180 ECTS; me kuotë 100 studente për vit akademik.*
- II.** Riakreditohet programi i studimeve të Kolegjit Universum për periudhën tri (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Biznes dhe Menaxhment, BA 180 ECTS; me kuotë 200 studente për vit akademik.*
- III.** Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV.** Obligohet Kolegji Universum që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V.** Obligohet Kolegji Universum të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Universum kampusi kryesorë në Prishtinë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	Psikologji, BSc, 180 ECTS;	Pranvera Collaku. Kaltrina Feka. Nazyktere Hasani dhe Zebide Ibrahim.
2.	Biznes dhe Menaxhment, BA 180 ETCS;(Prishtinë)	Sejdi Xhemajli. Muhamet Hajdari. Muhamet Spahiu. Berat Havolli dhe Fisnik Reqica.

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit të Kolegjit Universum.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Psikologji, BSc, 180 ECTS;** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 04.03.2025 me këtë përbërje: Kristjan Kask, Aysegül Kozak Cakir dhe Fatimazahra Javadzade. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; Biznes dhe Menaxhment, BA 180 ETCS;** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 20.03.2025 me këtë përbërje: Magdalena Iordache, Tornike Khoshtaria dhe Marija Vasilevska. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht tri (3) fushë të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrij ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Universum;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,